



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.114/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje(LVV) më seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega ne Malishevë, për shkak të vendosjes se posterav në objektin publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës se Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje(LVV), kështu që koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjobë ne vlerë prej 4,800.00 (katërmijë e tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarrimit**

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 06.06.2017 nga Lëvizjes Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, ka vërejtur se në Rrugën “Ibrahim Mazneku” në qendër të Malishevës, ishte vendosur posterat të kandidatit për deputet Fatmir Limaj nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, i cili ishte vërejtur nga aktivisti Bekim Gashi , diku rreth orës 16:25. Për këtë ne kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pikës (b) Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, vendosja e materialit zgjedhor ne apo mbi rrugë publike përbën veprim të ndaluar për subjektin politik, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas kësaj koalicioni me vendosjen e posterit në drunj në një shesh publik ka bërë shkelje të dispozitave se nenit 4.1 pikës b) të rregullores Zgjedhore 11/2013 dhe neni 3.4 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 1(një)fotografin të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të koalicionit PDK-AAK-NISMA, të datës 07.06.2017 thekson se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistët të painformuar mirë me rregullat zgjedhore respektivisht me Rregullën Zgjedhore nr.11/2013 neni 4.1(b). Edhe përkundër kësaj koalicioni ka ndërmarrë masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar sipas Anr.114/2017. Koalicioni ka evituar shkeljen dhe të gjitha këto veprime të ndërmarra provohen me dëshmi. Në përgjigjen në ankesë ka bashkangjitur 1(një) fotografi të cilat janë te printuar. Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se njoftimi për tubim nga koalicionit PDK-AAK-NISMA, është vendosur në objektin publik e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstatoi se nga provat e ofertuar shihet qartë se nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, është shkëlur neni 33,pika b) të LPZ-së, pasi që postieri i kandidati për deputet nga koalicioni në fjalë janë vendosur ne objektin publik ne Rrugën “Ibrahim Mazneku” në qytetin e Malishevës, në përgjigjën e ankesë të datës 07.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se janë vendosur posterat për kandidatin për deputet në objektin publike.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se koalicioni në fjalë , ia dha mundësin për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr postierat në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartasin e gjobës së shqiptuar si në dispozitivin të këtij vendimi.

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli, në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.114 /2017 më datën 07.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Zyhëd Haziri

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.